



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/16

Datë: 04.03.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 mars 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë –Ministarstvo Pravde –Ministry of Justice

**KONCEPT DOKUMENTIT PËR NDRYSHIMIN DHE
PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-141 PËR ADMINISTRIMIN
PASURISË SË SEKUESTRUAR OSE TË KONFISKUAR**

Kapitulli 1: Hyrje

Ministria e Drejtësisë si dikaster i Qeverisë së Republikës së Kosovës, vend të veçantë dhe shumë të rëndësishëm i ka dhënë aktivitetëve që mundësojnë efikasitet sa me te larte ne fushën e drejtësisë, këto ndryshime MD-ja i ka parapare ne Planin e Punës Objektivi 1. Krijimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet që dalin nga procesi i integritimit evropian, pika 1.8, si dhe me Planin Zhvillimor Strategjik i MD 2012-2016 ku me hartimin e këtij Projektligji do të kompletohet infrastruktura ligjore në fushën e administrimit te pasurive te sekuestruara në Republikën e Kosovës dhe do te evitohen paqartësitë që kanë të bëjnë me menaxhimin e efikas të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara dhe me proceset e nga ana e prokurorëve dhe gjykatave

Meqenëse tani më me legjislacionin penal është rregulluar çështja e konfiskimit te pasurive, tani më mbetet vetëm rregullimi sa me i detajuar i administrimit sa me te leverdishëm te pasurive te sekuestruara ose te konfiskuara duke filluar nga procedura e pranimit, vlerësimit ruajtjes se vlerës dhe shitjes. Proceset e parashikuara në ligjin e origjinës 03/L-141 nuk kanë qenë të deklaruar si[duhet. Si pasojë është krijuar një konfuzion nga ana Prokurorëve në lidhje me atë se kush e ka përgjegjësinë për t'i menaxhuar pasuritë e sekuestruara, gjithashtu është shkaktuar një konfuzion mbi natyrën e pasurive që Agjencia ka për mandat të administrojë, si dhe një mungesë informimi nga ana e prokurorëve për procesin ligjor të sekuestrimit. Kjo situatë ka dërguar në kryerjen e sekuestrimeve të paligjshme, me fjalë tjera prokurorët nuk ka kërkuar urdhër nga Gjykata pas periudhës prej 72 orësh që ata të mund të 'ngrijnë' një pasuri nën autoritetin e tyre. Nuk ka bazë ligjore për caktimin e administratorëve nga ana e Agjencisë, terminologjia në ligj (03/L-141) nuk është e njëjtë me atë të Kodit të Procedurës Penale.

Të gjitha këto çështje e dobësojnë efektivitetin e objektivave të këtij ligji i cili është për të menaxhuar në mënyrë efikase pasuritë që janë, apo përfaqësojnë, përfitime kriminale në një mënyrë që të ketë kosto sa më të efektshme gjatë kohës që u ruhet vlera e këtyre pasurive në pritje të një konfiskimi eventual nga Gjykata.

Projekti i financuar nga BE-ja në mbështetje të AAPSK-së e ka financuar një analizë ligjore të ligjit 03/L-141 – Ligji i AAPSK-së, dhe ka identifikuar një numër mangësish në këtë ligj të cilat ky koncept dokument ka për qëllim që t'i adresojë duke e rihartuar ligjin në mënyrë që këto mangësi të merren parasysh.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë se Sekuestruar ose te Konfiskuar

Rishikimi i kornizës Legjislative dhe institucionale të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive në Kosovë do të bëhet në kuadër të avancimit të kornizës ligjore dhe institucionale në funksion të sundimit të rendit dhe ligjit në pajtueshmëri me prioritetet dhe qëllime të përcaktuara nga Qeveria e Kosovës si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Tani ekziston një Direktivë e BE-së mbi Konfiskimin në të cilën i bëhet thirrje shteteve anëtare që të posedojnë një mënyrë efikase të menaxhimit të pasurive (përfitime nga krimi) që janë subjekt konfiskimi.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

Shpjegim

1. Përshkruani përmasat dhe kohëzgjatjen e problemit;

Me fillim të zbatimit të ligjit 03/L-141 nga viti 2010, praktika ka treguar mangësi dhe vështirësi (shiko paragrafin 2 më sipër) gjatë zbatimit të tij, të cilat edhe kanë krijuar këto probleme të cilat do të tentohet të evitohen në mënyrën më të mirë përmes ndryshimit të këtij ligji.

Me se shumti ndikim ka pasur në punën e Agjencisë. Zakonisht prokurorët nuk kërkojnë për një Sekuestrim edhe kur përfitimet kriminale janë të qarta, ose kur ata e bëjnë një gjë të tillë nuk i urdhërojnë pasuritë nën kujdestarinë e Agjencisë. Zakonisht prokurorët nuk konsultohen me Agjencinë për logjistikën, punët praktike dhe shpenzimet që ndërlidhen me një sekuestrim. Nëse do të kishin vepruar kështu do të kishin shqyrtuar mundësinë për të aplikuar për një sekuestrim dhe shitje të menjëhershme të pasurive që zhvleftësohen shpejt në mënyrë që t'u ruhet vlera.

Jo gjithnjë prokurorët aplikojnë për konfiskim të përfitimeve kriminale kur ato ekzistojnë në një çështje. Arsyeja për këtë është e paqartë. Pa një funksionim të qëndrueshëm të konfiskimit puna e Agjencisë është e mohuar, rrjedha e të ardhurave nga konfiskimet është minimale, Shteti i Kosovës nuk ka kredibilitet brenda bashkësisë ndërkombëtare në këtë fushë dhe kriminelët i mbajnë pasuritë e tyre.

Pasi që Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK), është Agjenci Ekzekutive për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, sa i përket administrimit të pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara, mund të

themi se kjo problematikë prek të gjithë territorin dhe është e vështirë të precizohet një vend apo disa vende.

Gjykata dhe Prokuroritë

2. Përdorni një tabelë për përshkrimin e kohëzgjatjes dhe përmasave (tabelën përgatiteni në bazë të informatave të juaja);
3. Përshkruani trendët sa kanë të bëjë me përmasat, lokacionin ose kohëzgjatjen e problemit. Ky ka qenë një problem konstant që nga fillimet e Agjencisë. Ashtu si Prokurorët dhe Gjykatat, edhe policia e Kosovës, Doganat, Komisioni i Minierave dhe Mineraleve, Agjencia e Veterinarisë që të gjitha i kanë referuar Agjencisë objekte, pasuri, kafshë etj, mbi besimin e gabuar se është një ambient që mbledh gjithçka që sekuestrohet si 'pasuri'. Agjencia është themeluar për të vepruar me ato pasuri që janë, apo përfaqësojnë, të ardhurat nga krimi/përfitimet kriminale të cilat janë të synuara që eventualisht të sekuestrohen dhe të shiten.

Vlera e përafërte e pasurisë në administrim nga Agjencia ndër vite:

2010≈ 1,720.00€;
2011≈ 70,000.00€;
2012≈2,500,000.00€;
2013 - 1,600,000.00€;
2014 - 3,592,003.62 €.

Informata

1.

Administrimi i pasurive të sekuestruar ose të konfiskuar konform vendimeve gjyqësore është një fushë e re në Kosovë që cila është secilën herë është përmirësuar por që akoma ka disa mangësi. Për këtë çështje janë bërë analiza, studime, konsultime çdo herë në harmoni të plotë me mandatin e AAPSK-së. Të gjitha raportet e dalura kanë ofruar edhe opsionet të cilat do ndikojnë në administrim efikase. Prandaj gjendja aktuale nuk është shume e sqaruar dhe here-here ka edhe konfuzione në Ligjin aktual. Nga analizat dhe rekomandimet është dalur se duhet të jete me e detajuar koordinimi paraprak për sekuestrim ose konfiskim dhe të jete e sqaruar me tepër mandate të Agjencisë. Problemi kryesor është që Prokurorët në përgjithësi nuk e kuptojnë procesin e sekuestrimit dhe konfiskimit eventual. Ata qartësisht hezitojnë në zbatimin e kësaj përgjegjësie. Barra e identifikimit të përfitimeve kriminale, renditja e tyre në aktakuzë dhe më pas të kërkuarit Gjykatës për konfiskimin e përfitimeve në fjalë pas dhënies së dënimit, mbetet e prokurorit dhe ata e bëjnë rrallë një gjë të tillë.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

Nuk ka asnjë arsye përse prokurorët të mos ndërliidhen më shumë me Agjencinë kur duan të ndërmarrin sekuestrime. Kodi i Procedurës Penale vendos një obligim mbi Prokurorët që të kenë parasysh gjasat për zhvlerësimin dhe shpenzimet administrative. Duket e vështirë që të mund t'i vlerësojnë këto çështje pa e konsultuar Agjencinë. Kryeprokurori i shtetit ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ në Shkurt 2014 i cili u kërkon prokurorëve të shtetit që t'a konsultojnë Agjencinë në rastet kur përgatisin një sekuestrim. KPK-ja tani ka caktuar një Koordinator Kombëtar për Krimet Ekonomike për të ndihmuar në fokusimin e aktivitetit të prokurorëve në konfiskimin e pasurive. Kjo duhet të rrisë kontaktet dhe bashkëpunimin ndërmjet Agjencisë dhe Prokurorëve. Ende është e nevojshme qartësimi i mandatit të Agjencisë në ligj.

Mandati i AAPSK-së është shumë i gjerë dhe i paqartë dhe nuk specifikon se në cilat raste Agjencia merr pasurinë nga autoritetet e tjera të tilla si gjykatat, prokuroria dhe organet e tjera kompetente. Përveç kësaj, ligji nuk përmend se çfarë lloj të pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara bien nën mandatin e saj ashtu siç është praktika në vendet e tjera që kanë miratuar ligje të ngjashme. Neni 2 i Ligjit kufizon objektin e pronës për menaxhim nga AAPSK-ja vetëm në pronën në qarkullim të lirë juridik i cili ka sjellë shumë konfuzion në mesin e praktikuesve të ndryshëm në fushën e sekuestrimit/konfiskimit. Qarkullimi juridik duhet të përkufizohet në mënyrë të qartë për faktin që nuk ekziston një përkufizim në ligjin aktual. Këtu nuk duhet të përfshihen drogat, nuk duhet të përfshijë sende të cilat janë kontrabanduar apo që janë subjekt i një ndalimi apo kufizimi të shitjes dhe përdorimit të tyre në Kosovë, nuk duhet të përfshijë sende të cilat janë subjekt i konfiskimit automatik (të menjëhershëm) sipas ligjit të tilla si sendet e përdorura në kryerjen e një veprë, nuk duhet të përfshijë sende që janë subjekt i taksave që mbliidhen nga ATK-ja.

Projektligji duhet që të përfshijë një sistem që administron efektivisht pasuritë e ngrira, sekuestruara dhe të konfiskuara dhe kur është e nevojshme, asgjësimin e pronës së tillë.

AAPSK duhet të marrë dhe të menaxhojë vetëm pasuritë që janë cak për konfiskim dhe jo sendet të sekuestruara si prova. Zinxhiri i kujdestarisë së provave duhet ti mbetet prokurorit ose policisë dhe AAPSK-ja merr kujdestarinë vetëm pasi sendet nuk janë më të nevojshme në procedurat ligjore. Gjithsesi KPP-ja parashikon që Agjencia mund të mbajë prova. Është e qartë që kjo është në rrethana kur një send i mbajtur si provë poashtu është edhe një e ardhur nga krimi dhe prandaj edhe është e synuar që të konfiskohet, të tillë si makina e përdorur në një veprë penale poashtu është edhe një përfitim kriminal duhet të konfiskohet dhe të shitet.

Politika aktuale

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar mbanë përgjegjësi për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar që i janë besuar në përkujdesje nga Autoritet Kompetente(bashkëpunim Gjykatën, prokurorinë, Policinë, Doganën, AUV, KPMM etj.), që në fushëveprim kanë sekuestrimin ose konfiskimin.

Pas marrjes së vendimit që lëshohet nga Gjykata me kërkesë të prokurorit për sekuestrim ose konfiskim pasurinë ia kanë dërguar Agjencisë për Administrimin e mëtutjeshëm konform Vendimit.

Agjencia ka ruajtur dhe administruar pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në bashkëpunim me prokurorinë, gjykatën, apo organet tjera kompetente, në pajtim me ligjin në fuqi, me përjashtim të pasurisë së konfiskuar për realizimin dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore nga Administrata Tatimore e Kosovës ose Dogana;

Agjencia ndihmon në ekzekutimin e vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, sipas kërkesës së organeve kompetente, Agjencia mundëson shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar, sipas autorizimit të organit kompetent. Agjencia ka mbajtur 3 takime të përbashkëta në qarkun e 12 muajve të fundit ku të gjitha palët e interesit përfshirë policinë, doganat, prokurorë, gjykatës, të komisionit të minierave, agjencisë së veterinarisë janë bashkuar së bashku për të diskutuar çështje që nevojitet zgjidhja e tyre.

Agjencia ndërmer veprime të nevojshme për ruajtjen adekuate dhe sigurimin e vlerës së pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar. Ruajtja e vlerës mund të sigurohet me mbajtjen apo shitjen e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar nga ana e Agjencisë, në mënyrë që të zëvendësohet me një kundërvlerë monetare. Agjencia angazhon ekspert sipas nevojës për vlerësimin e vlerës së pasurisë dhe mënyrën e ruajtjes së sendit të sekuestruar ose të konfiskuar. Të hyrat e realizuara nga shitja deponohen në xhirollogarinë bankare të Agjencisë në Bankën Qendror të Republikës së Kosovës. Në rastet e veçanta Agjencia mund të kërkoj nga gjykata apo organi tjetër kompetent që pasuria e sekuestruar t'i lihet për ruajtje apo shfrytëzim personit të cilit i është sekuestruar sendi.

Agjencia administron të dhënat lidhur me pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar në një sistem të centralizuar kompjuterik. Çdo person fizik apo juridik, të cilit i është sekuestruar ose konfiskuar pasuria, ka të drejtë të kërkojë dhe të informohet nga agjencia për pasurinë e tij të sekuestruar ose të konfiskuar.

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar si organ kompetent nën autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë.

Organet kompetente për sekuestrim ose konfiskim i përcjellin Vendimin për Administrim Agjencisë e cila në afatin e parapare ligjore e marr në administrim pasurinë e sekuestruar ose të konfiskuar.

Në problemet e paraqitura kanë qenë se të gjitha organet edhe pa vendim gjykate ia kanë përcjell për administrim pasurinë Agjencisë. Ndërsa me ndryshimet ligjore në kodin proceduror penale prokurori ia propozon gjykatës dhe gjykata vendosë se cila pasuri duhet të sekuestrohet apo konfiskohet dhe Agjencia vepron konformë këtij Vendimi.

Legjislacioni penal i parasheh afatet ligjore brenda të cilave Agjencia duhet të pranojë një pasuri në pajtim me përshkrimin që Gjykata ka vendosur me Vendim.

Ligjet dhe aktet nënligjore

Çështja kryesore është shpjeguar në Kapitullin 1. Ekzistojnë mangësi në ligjin e AAPSK-së që kanë dërguar në keqkuptime në lidhje me mandatin e Agjencisë dhe kanë penguar administrimin efikas të pasurive të sekuestruara, apo që janë në proces të sekuestrimit. Ligji i AAPSK-së nuk parasheh ripërdorimin e pasurive për qëllime shoqërore.

Legjislacioni i aplikueshëm në Kosovë ka paraparë masa për sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të fituara me vepra të jashtë-ligjshme. Sekuestrimi dhe konfiskimi i produkteve të fituara me vepra penale në Kosovë është i rregulluar me disa ligje, si:

- Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (Ligji 2010), i cili themeloi Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK), si një Agjenci Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë;
- Kodi Penal i Republikës së Kosovës,
- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të dy këto ligje janë kaluar me 2013, dhe kanë sjellë përmirësime në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit pasi që i dhanë hetuesve dhe prokurorëve në Kosovë mjete, për të

identifikuar dhe konfiskuar fitimet e të gjitha veprave penale, të krahasueshme me ato të vendeve të zhvilluara.

- Ligji për Zgjerimin e Kompetencave të Konfiskimit (LZKK), e cili hyri në fuqi në 2013 lejon një prokuror të kërkojë konfiskimin e pasurive kur i pandehuri vdes, është i arratisur, ose ka pronë që nuk mund të shpjegohet nga të ardhurat e ligjshme.
- Ligjin për administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara dhe legjislacionin dytësor, përfshirë Udhëzimin Administrative, Nr. 1/2010 për strukturën funksionale dhe organizative të Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar; Urdhëresën administrative 1/2010 për sistematizimin dhe përshtatimin e vendeve të punës për nëpunësit civil të Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar; Urdhëresën administrative Nr. 04/2011 për pranimin, vlerësimin, ruajtjen e vlerës, asgjësimin dhe shitjen e pasurisë së sekuestruara ose të konfiskuara; Kodin e mirësjelljes për zyrtaret e Agjencisë për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar; Rregulloren e brendshme Nr. 02/2011 për menaxhimin e të dhënave; dhe rregulloren e brendshme Nr. 1/2011 për detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të pasurisë së sekuestruara ose të konfiskuara.

Shpenzimet aktuale

	Shpenzimet	Buxheti	KASH për
--	------------	---------	----------

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

Kategoria e shpenzimeve	faktike në vitin paraprak	këtë vit	vitin e ardhshëm
Buxheti i Ministrisë: AAPSK (shëno secilin lloj të shpenzimit)	Gjithsej : 249,651.24 €, ose 1 Paga dhe Mëditje 135,209.35 2 Mallra dhe Shërbime 114,441.89	Gjithsej: 369,406.65 €, ose 1. Paga dhe Mëditje 163,157.65 € 2. Mallra dhe Shërbime 206,249.00	Gjithsej: 369,406.65 €
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)			
Financimi nga donatorët			
Shpenzimet drejtpërdrejta nga Ministria e Financave			

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Ne këtë fazë Agjencia nuk ka të detajuar mandatin e saj ligjore, sa i përket konsultimeve paraprak që vijën deri tek marrja e një Vendim për sekuestrim ose konfiskim, po ashtu shitja e pasurive që shpejta i humbe vlera dhe kushtet e magazinimit nuk janë adekuate, nuk është e përcaktuar detajisht.

Shpenzimet e administrimit kanë kosto të larta. Këto shpenzime vijnë si pasojë e kujdesit dhe administrimit që Agjencia ndërmerr për të menaxhuar pasuri të tilla si paluajtshmeritë, bizneset, plantacione dhe makineri në rastet kur pasuria nuk mund të shitet apo kur shitja është kërkuar por akoma nuk është vënë në veprim nga prokurori.

MD-ja duhet t'ia propozojë këtë gjë MF-së dhe pasi të dakordohen t'i kalohet pastaj Parlamentit për miratim përpara rishikimit vjetor të buxhetit.

Këto ndryshime janë pare të nevojshme në këtë fushë të rëndësishme sepse gjatë proceseve here here të gjata e të kushtueshme që synojnë konfiskimin e pasurisë, është e nevojshme në këtë fazë të ruhet vlera e pasurive të sekuestruara. Këto ndryshime kanë për qëllim që shtetit të Kosovës ti ndihmohet ruajtja e vlerës së pasurive të sekuestruara gjatë zhvillimit të procedurës së konfiskimit dhe përfitimi i shtetit nga këto pasuri pasi që për to, të jete marre vendimi përfundimtar për Konfiskim dhe përdorimi i këtyre pasurive në pronësi të shtetit.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-141 për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

Pasi qe këtyre pasurive tu mundësohet ruajtja e vlerës edhe ne kundërvlera monetare dhe pastaj ne qofte se Gjykata vendos qe pasuria ti kthehen palës atëherë Agjencia te jete ne gjendje te kthej kundërvlerën e asaj pasurie te sekuestruar.

Nëse një pasuri e sekuestruar mbahet gjate ne administrim nga Ana e Agjencisë atëherë ka kosto te larte varësisht nga lloji i pasurisë edhe shpenzimet e administrimit munde te jete te larta.

Agjencia nuk munde te ndërmerr hapat e nevojshëm për shitjen e pasurive ne administrim pa një Vendim Gjyqësore i cili munde te vonoj. Por nuk duhet të marrë kohe normalisht!

Agjencie për te arritur objektivin e politikës se propozuar, nevojitet bashkëpunim dhe koordinim ndërinstytucional me organet ligje-zbatuese duke pasur parasysh qe pasuritë e sekuestruar ose te konfiskuar mund te gjinden ne te tere territorin e Republikës se Kosovës. Koordinimi dhe bashkëpunimi me aktorët dhe institucionet sa i përket administrimit te pasurive te sekuestruar ose te konfiskuar do te duhej te ishte obligim ligjore i shtetit tone.

Përvoja në shtetet tjera

Duke qenë se shtetet e tjera të rajonit fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të fituara me vepra të jashtë-ligjshme e kanë të rregulluar në mënyrë të ndryshme atëherë konsiderohet se politikat e tyre nuk janë të duhura për të adresuar problemet të cilat hasen në Kosovë. Megjithatë, janë analizuar praktikat më të mira të disa vendeve të Bashkimit Evropian si dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, aplikimi i të cilave mund të ketë sukses në zgjidhjen e problemit në Kosovë. Agjencia ka vizituar Agjencinë Belge (COSC-Shqip: ZQSC{Zyra Qendrore për Sekuestrim dhe Konfiskim}). Belgjika ka legjislacion të ngjashëm por arrit sukses më të madh sepse prokurorët dhe hetuesit e pasurive dhe menaxhuesit janë të gjithë në një institucion. Gjithashtu ata janë të motivuar dhe të praktikuar në konfiskimin e pasurive. Ne mendojmë që Belgjika është modeli më i mirë për të ndjekur.

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë se Sekuestruar ose te Konfiskuar

Objektivat

Për arritjen e objektivave do të bëhet:

1. Përmirësimi i kornizës ligjore për menaxhimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara.
2. Zvogëlimin e kostos të menaxhimit
3. Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet agjencisë dhe prokurorëve dhe aktorëve tjerë shtetërorë duke rezultuar me një rritje të shpeshtësisë së sekuestrimit dhe konfiskimit.

Koordinimi paraprak sa i përket sekuestrimit ose konfiskimit në mes të institucioneve zbatuese të ligjit, me qëllim të uljes së kostos së administrimit. Kjo mund të arrihet me anë të një takimi në baza mujore ndërmjet Koordinatorit Kombëtar dhe Agjencisë, për të identifikuar të gjitha sekuestrimet dhe rishikuar ato për të cilat mund të realizohet një shitje në një fazë të hershme.

Plotësimin dhe ndryshimin e rregullave të përcaktuara ku ndryshon dhe plotëson procedurën e pranimit të pasurisë nga Organet e zbatimit të ligjit si në procedurën e sekuestrimit ose të konfiskimit duke përfshirë por mos u kufizuar në fazën e sekuestrimit, konfiskimit të zgjeruar, konfiskimit pa vendim Gjykatë, konfiskimi nga pala e tretë e gjithë kjo me qëllim të administrimit sa më të mirë për ruajtje adekuate dhe sigurimin e vlerës deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës ose shitjen e kësaj pasurime nëse kjo rrezikon të prishet ose zhvlerësohet shpejt.

Do të ulen kostoja menaxhimit dhe ruajtja e vlerës së pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara

Procedura e detajuar e pranimit, vlerësimit dhe ruajtjes së vlerës së pasurive të sekuestruara ose të konfiskuara dhe në fund shitja sipas vendimit të gjykatës dhe deponimi i mjeteve në llogarinë bankare të Agjencisë.

Vetëm me zbatimin e ligjit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional kjo çështje është e arritshme në mënyrën më të mirë të mundshme.

Sapo që ndryshimet ligjore të hynë në fuqi

Kapitulli 4: Opsionet

Duhet të përfshini së paku tri opsione ose mënyra për zgjidhjen e problemit.

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe kostoja e larte e administrimit te pasurisë se sekuestruar

Pasuritë nuk munde te pranohen me kohe dhe zhvlerësimi i tyre do te jete i madhe

1. Shpjegoni se si zbatohet status quo.

- Problemet e nxjerra në pa nga analiza ligjore vazhdojnë.
- Mandati i Agjencisë do të mbesë i paqartë
- Nuk do të ketë ligj që pasuritë e konfiskuara të mund të përdoren për qëllime shoqërore apo qeveritare
- Nuk do të ketë bazë ligjore për caktimin e administratorëve
- Ligji i AAPSK-së do vazhdojë të jetë jo në harmoni me Kodin e Procedurës Penale
- Do të vazhdojë gjendja e të mos paturit përkufizim për pasuritë që duhet të menaxhohen (në qarkullim të lirë juridik)

2.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Neni 2 i ligjit aktual (03/L-141) duhet të zgjerohet për të përkufizuar [farë është në 'Qarkullim të lirë Juridik'. Duhet të deklarohet në mënyrë eksplicite që qëllimi i Agjencisë është që të menaxhojë pasuri që janë përfitime kriminale që janë subjekt i një konfiskimi eventual nga një Gjykatë.

Nevojitet një Nen i ri për t'i dhënë Agjencisë kompetenca për të caktuar administratorë nëse Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë e kërkon.

Duhet të ketë dispozita për të bërë të mundur përdorimin e pasurive të konfiskuara për nevoja shoqërore apo Qeveritare.

Në ligjin e rihartuar terminologjia e përdorur në lidhje me përfitimet kriminale /të ardhura nga krimi duhet të bashkërenditet me atë të Kodit të Procedurës Penale.

Me qartësimin e mandatit te Agjencisë, Planifikimin parasekuestrimit; nga cili organ do te pranohen pasuritë; shitja e pasurive te sekuestruara me vendim sa me te shpejte gjyqësor

Për administrimin e pasurive te sekuestruar duhet te krijohen mekanizma sa me te efektshëm e me kosto sa me te ulet si dhe procedurat e caktimit te administratorëve te pasurisë siç është përcaktuar më larte për llojet e pasurive te sekuestruara qe kanë nevoje për Administrim te veçantë si për shembull ne rastin e çështjeve te ndërlikuara si: kur behet fjale për sekuestrimin e një veprimtarie tregtare te ligjshme ne aktivitet te plote, prania e një administratori te pavarura mund te këtë sukses te veçante.

Për qëllim të administrimit të leverdishme të këtyre pasurive është parapare që ti vazhdohet puna Agjencisë për Administrimin e pasurive të sekuestruar ose të konfiskuar si organ i specializuar për këtë çështje. Po ashtu ndër detyrat këtij institucioni është të kontrolloj pasuritë që janë në administrim si shtëpiak i mirë (*bonos paterfamilias*) dhe puna e tij të jete transparente. Të hyrat nga pasurit e sekuestruara ose konfiskuara do të administrohen në mënyre sa më të leverdishme dhe të njëjta do të procedohen konform legjislacionit në fuqi. Dhe për administrim të këtyre pasurive shteti duhet të marrë parasysh edhe futjen në përdorim të sistemeve të ndryshme teknologjike të informacionit(IT). Këto sisteme janë të përshtatshme për administrimin financiar dhe për mbajtjen e inventarit ose llogaritjen e shpenzimeve të pasurive në fjale si dhe për mbajtjen e një sistemi transparent të besueshëm.

Kur një pasuri është sekuestruar, përveç rasteve kur autorizohet shitja e saj paraprake, ajo duhet ruajtur në të njëjtat kushte në të cilat ruhet në momentin e sekuestrimit.

Është e rëndësishme që të vlerësohen pasurit e sekuestruara me qëllim të përcaktimit të vlerës së saj në treg, në një moment të caktuar. Për këtë qëllim për pasuri specifike mund të caktohen edhe ekspert të fushës.

Në këtë ligj do të parashikohet shitja e pasurive të sekuestruara për të cilët akoma është duke u zhvilluar procedure edhe atë për ato lloje të pasurive që prishen ose zhvleftësohen me shpejtësi. Me tej shteti duhet të autorizojnë shitjen e pasurive që është vështirë të mbahen. Kjo duhet të jetë pjesë e diskutimeve para sekuestrimit ndërmjet Prokurorëve dhe Agjencisë. Nëse pasuria është e vështirë që të mirëmbahet, pra është e kushtueshme, atëherë prokurori duhet të kërkojë menjëherë një Urdhër sekuestrimi/Ndalues dhe SHITJEN e pasurisë, të ia kalojë Agjencisë Urdhrit (pasi ta ketë siguruar një të tillë) për të ekzekutuar shitjen dhe për të vendosur të ardhurat në BQK në pritje të rezultatit të gjyqit dhe eventualisht të Urdhrit për Konfiskim.

Përfitimet nga shitja duhet të ruhen në një llogari të veçanta siç do të jete e përcaktuar me këtë ligj. Për këtë shitje pastaj duhet të njoftohet gjykata e cila ka marrë vendim për sekuestrim dhe për shitjen e kësaj pasurie për të cilën pasuri është në pritje një vendim përfundimtar.

Përgjegjës do të jete Gjykata,prokuroria dhe Agjencia. Prokurori i kërkon Gjykatës për të Sekuestruar (ose konfiskuar) duke lëshuar Urdhrit e duhur dhe Agjencia e ekzekuton vendimin.

Në pajtim me ligjin në fuqi. Urdhri Ndalues (që do të thotë sekuestrim) dhe urdhrat për Konfiskim nxirren në bazë të seksioneve të duhura të Kodit të Procedurës Penale. Kodi Penal kërkon që të gjitha përfitimet kriminale të konfiskohen.

1.

Do të ishte e nevojshme por mundësit buxhetore janë të kufizuara.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar

Nuk ka nevoje tryeza, seminare apo diçka te ngjashme do te organizoheshin nga Agjencia se bashku me institucionet tjera ligjzbatuese.

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistues të zbatimit

1. Shpjegoni se çka do të ndodhë nëse ligji/politika ekzistuese qëndron, por ndryshohet mënyra e zbatimit.

Nuk munde te zbatohet ndryshe sepse është përcaktuar me ligj.

2. Kush do të jetë përgjegjës?
3. Shpjegoni se çfarë trajnime apo ndryshime tjera duhet të zbatohen.
4. Shpjegoni se çfarë burime shtesë ose ndihmë tjetër nevojitet.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Përgatitni një tabelë që i përmbledh opsionet duke përdorur formën më poshtë. Kjo përmbledhje do t’iu ndihmojë të identifikoni informatat që mund të mungojnë, ose informatat të cilat do ta bëjnë secilin opsion shumë të qartë për vendimmarrësit.

Përmbledhje e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Nuk ka ndryshime	Një draft i ri i Ligjit	n/a
Segmenti i popullsisë/ sektori/ rajoni i shënjestruar		Konfiskimi i të ardhurave nga krimi. AAPSK/MD	
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët			
Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit		AAPSK	
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet			
Stimulimet ose mos-		n/a	

stimulimet ekonomike – subvencionet ose taksat			
Fushatat e edukimit dhe komunikimit		n/a	
Udhëzimet dhe kodet		Rihartimi i ligjit 03/L-141	
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni		Sa më parë	

Duke marrë në konsideratë opsioni e dyte dhe opsionin e rekomanduar do të qartësohej mandati ligjore i administrimit të pasurive nga ana e Agjencisë, do të ishte i mirëseardhur konsultimi paraprak, do të krijohen mekanizma sa më të efektshëm e me kosto sa më të ulët të administrimit, do të rregullohej mënyra e administrimit të pasurive specifike duke angazhuar administratore dhe precizuar mënyrën e përzgjedhjes së tyre siç do të definohej për vlerësimin e pasurive specifike që do vlerësoheshin nga ekspert të fushës, do të synohej ruajtja e vlerës së pasurive edhe me shitje për gjerat që mund të ju humbe vlera shpejt. Një çështje e rëndësishme që do të definohej është edhe përdorimi i pasurive nga ana e shtetit.

Ky ripërdorim i pasurive që janë vetëm të sekuestruara duhet të ndërmerret në raste të veçanta, si p.sh një bllok apartamentesh apo një Zyrë dhe kur është mundësia që shteti ta përdorë për nevojat e veta nëse pronari i vërtetë nuk mund të xhindet apo të ndiqet penalisht apo kur procedurat e ligjit për kompetenca të zgjeruara të konfiskimit nuk mund të përdoren, pastaj Agjencia do të përfundojë me një pasuri të sekuestruar përgjithnjë me pamundësi për t'u konfiskuar dhe për këtë arsye do t'i duhet të gjejë një mënyrë për t'a përdorur pasurinë për ta parandaluar humbjen në resurse. Kjo paraqet nevojën për të patur një ligj i cili e lejon konfiskimin e përhershëm në këto raste por kjo duhet të gjendet në KP apo KPP dhe jo në Ligjin e AAPSK-së.

Pas konfiskimit mund të ketë raste që pasuritë mund të ripërdoren nga Shteti, p.sh. automjete, mjete fluturuese, paluajtshmëri. Një përcaktim për ripërdorimin e tyre (pas konfiskimit) duhet të bëhet nga AAPSK-ja dhe kjo e fundit mund të ftojë organet Shtetërore për t'ju ofruar ripërdorimin e tyre. Vlera nominale e pasurisë duhet të shënohet në regjistrat e AAPSK-së si një e hyrë. Shteti mund të vendosë për të dhuruar një pasuri e cila mund të jetë e përshtatshme për ripërdorim të shoqërisë civile. Ky vendim duhet të merret nga Ministri i Drejtësisë.

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. **Opsioni 1 (*status quo*).**Me bashkëpunim ndërinstytucional dhe administrim te leverdishme te pasurive te sekuestruara ose te konfiskuara do te përfitonte shteti sepse ne buxhet do te kishte me pak shpenzime dhe me shume te hyra.
2. **Opsioni 2.**
Qartësimin e mandatit te Agjencisë, heqja e paqartësive, bashkërendim më i mirë me Prokurorët përmes planifikimit të parasekuestrimit; nga cili organ do te pranohen pasuritë; shitja e pasurive te sekuestruara me vendim sa me te shpejte gjyqësor.
Do te rregullohej ne atë mënyre qe te hyrat nga pasurit e sekuestruara ose konfiskuara do te administrohen ne mënyre sa me te leverdishme dhe te njëjta do te procedohen konform legjislacionit ne fuqi. Dhe për administrim te këtyre pasurive shteti duhet te marre parasysh edhe futjen ne përdorim te sistemeve te ndryshme teknologjike te informacionit (IT). Këto sisteme janë te përshtatshme për administrimin financiar dhe për mbajtjen e inventarit ose llogaritjen e shpenzimeve te pasurive ne fjale si dhe për mbajtjen e një sistemi transparent te besueshëm.

Opsioni 3.

Pasojat negative

1. **Opsionit 1 (*status quo*).**Kostoja e shpenzimeve e larte për pasuritë qe shpejt ju humbe vlera.
2. **Opsioni 2.** Proceset e sekuestrimit dhe të administrimit janë më të bashkërenduar, menaxhimi i pasurive është më efikas i cili rezulton me më shumë të ardhura për Shtetin
3. **Opsioni 3 (ndryshimi i administrimit ose zbatimit).** Efekti shpërndarës

Kjo çështje është e ndërlidhur ne mes te Agjencisë, Prokurorisë dhe Gjykatës. Munde te themi se ka vetëm efekte pozitive nga te cilat mund te përfitojnë edhe viktimat e krimit nga shitja eventuale e këtyre pasurive.

Kosto

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/l-141 për Administrimin Pasurisë se Sekuestruar ose te Konfiskuar

Secili opsion do të ketë koston e tij. Përfshini një tabelë e cila përshkruan koston e përafërt të secilit opsion. Një tabelë përmbledhëse është dhënë më poshtë. Të gjitha ministritë duhet të respektojnë udhëzimet përkatëse të nxjerra nga Ministria e Financave, në pajtim me nenin 31 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011.

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1	Gjithsej : 369,406.65 €	Gjithsej : 369,406.65 €	Gjithsej : 369,406.65 €	Gjithsej : 369,406.65 €
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				
Financimi i pritur nga donatorët				
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve				
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave				

Financimi i pritur nga donatorët				
----------------------------------	--	--	--	--

Në një Aneks të veçantë duhet të përfshihet një tabelë e hollësishme e ndikimit financiar të secilit opsion. Kjo tabelë duhet të përmbajë informatat relevante në formularin e Vlerësimit të Ndikimit Financiar. Politika jone e propozuar nuk parasheh implikime buxhetore.

Kapitulli 7: Konsultimi

Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë, në universitete ose agjenci)

Konsultimet për plotësim ndryshimin e Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar ose konfiskuar kanë filluar më herët dhe kjo ka qenë një ndër kërkesat që është paraqitur nga AAPSK-ja. Konsultimet janë bere me prokuror gjykatës dhe ekspert te projektit te KE-se ne mbështetje te Agjencisë. Vlen te përmendet se kemi pasur takime të mbështetura nga projekti i KE-se ne mbështetje të Agjencisë ku kane marre pjese përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, Përfaqësues te Prokurorive Themelore dhe Përfaqësues Te Gjykatave Themelore te vendit, Policisë, Doganave.

Është pare e nevojshme qe te detajohet mandati i Agjencisë, cilat pasuri do te duhej te administroheshin nga agjencia dhe çështjet tjerat te përshkruara me lartë

Ne takimet me Gjykatës, prokurore, polici, dogana edhe institucionet tjera ligjzbatuese janë pajtuar qe duhet te mos ketë kolizion ligjore dhe çështjet te definohen me ndryshimet e propozuara.

Jem konsultuar me organet ligjzbatuese në vend dhe ekspert te BE-së të kësaj fushe gjatë vlerësimit te problemit.

Rekomandohet që Ligji duhet të ndryshohet për të futur një përkufizim të qartë të mandatit të AAPSK-së, duke përfshirë autoritetet nga të cilët Agjencia duhet të pranoj pasuritë e sekuestruara ose të konfiskuara. Gjithashtu, ndryshimet duhet të përfshijnë dispozita që përcaktojnë qartë llojin e pasurisë së sekuestruar ose të konfiskuar që është subjekt i administrimit nga Agjencisë; rekomandohet që ligji duhet të ndryshohet që të përfshijë një sistem që menaxhon efektivisht pasuritë e ngrira, sekuestruara dhe të konfiskuara dhe kur është e nevojshme, asgjësimin e pronës së tillë; Terminologjia e përdorur në ligj që rregullon pune e Agjencisë dhe në KPP-në është në kundërshtim. Sipas Ligjit AAPSK-ja është përgjegjëse në asistimin e ekzekutimit të vendimeve për sekuestrimin ose konfiskimin e pasurisë, sipas kërkesës nga autoritetet kompetente.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë së Sekuestruar ose te Konfiskuar

Kodi i Procedurës Penale e obligon AAPSK-në për ekzekutimin e urdhrave të gjykatës në çështjet e masave të përkohshme për sigurimin e pasurisë.

Terminologjia e njëjtë duhet të përdoret në të gjithë legjislacionin për të larguar paqartësitë; AAPSK-ja nuk duhet të menaxhojë/ruajë pasuritë që janë objekt i administrimit nga organet tjera qeveritare/agjencitë. AAPSK-ja udhëhiqet nga Ligji i saj dhe KPP-ja i ri i cili gjithashtu i jep fuqi AAPSK-së për të menaxhuar/administruar sekuestrimin/konfiskimin e pasurive të fituara nga vepra penale; AAPSK-ja nuk duhet të pranojë dhe të administrojë pasuritë përmes një urdhri të prokurorit. AAPSK-ja administron pasurinë e sekuestruar ose konfiskuar vetëm nëpërmjet urdhrit të gjykatës; AAPSK duhet të marrë dhe të administroj vetëm pasuritë që janë cak për konfiskim dhe jo sendet të sekuestruara si prova. Zinxhiri i kujdestarisë së provave duhet ti mbetet prokurorit ose policisë dhe AAPSK-ja merr kujdestarinë vetëm pasi sendet nuk janë më të nevojshme në procedurat ligjore; Në rastet kur paratë janë konfiskuar, AAPSK-ja duhet të merr vetëm fondet e certifikuara apo draftet bankare dhe jo vet paratë, siç ka qenë në praktikë; Të sigurojë se urdhëratë për konfiskim zbatohen në mënyrë efektive. Pasi të jenë lëshuar nga gjykatat, urdhëratë për konfiskim duhet të zbatohen si duhet.

Pos me organet ligjzbatuese, akoma nuk ka pasur konsultime me OJQ-të.

Konsultimet për plotësim ndryshimin e Ligjit për administrimin e pasurisë se sekuestruar ose konfiskuar kanë filluar më herët dhe kjo ka qenë një ndër kërkesat që është paraqitur nga AAPSK-ja. Konsultimet janë bere me prokuror gjykatës dhe ekspert te projektit te KE-se ne mbështetje te Agjencisë.

Ministria e Drejtësisë, do jetë e përqendruar në ofrimin e mundësisë akterëve që të informohen për detajet e procesit të punës rreth hartimit të Projektligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë se Sekuestruar ose Konfiskuar. Format e komunikimit do të bëhen konform Rregullores se Punës se Qeverise. Po ashtu do te jenë përmes takimeve, grupeve punuese, takimet me grupe të interesit dhe publikimin në ueb faqe të internetit. Varësisht prej periudhës kohore të punës në projektligj, komunikimi do të jetë i menjëhershëm dhe shumë konstruktiv ashtu siç e parasheh legjislacioni në fuqi.

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve (vlerëso pasojat e secilit opsion)

Moskordinimi dhe rritja e koston se menaxhimit te pasurive.

Përfitim do te je te bashkëpunimi ndërinstytucional, qartësimi i mandatit te punës se Agjencisë.

Koncept Dokumentit për hartimin e projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/1-141 për Administrimin Pasurisë se Sekuestruar ose te Konfiskuar

Të gjitha opsionet e shqyrtuara objektiv kanë një koordinim sa me te mire ne çështjet e sekuestrimit ose te konfiskimit me institucionet tjera ligje zbatues. Me këtë projektligj do krijohen rrethana me te favorshme te bashkëpunimit ndërinstytucional ne fushën e administrimit te pasurive te sekuestruara ose konfiskuara.

Në rrethanat ekzistuese, është e pamundur që të parashikohet me saktësi të plotë kostoja financiare e alternativës së rekomanduar. Megjithatë nga analizat preliminare të bërë nuk parashihet ndonjë kosto si rezultat i këtyre ndryshimeve.

Ky opsion nuk kërkon ndonjë ndryshim sa i përket politikave ekzistuese dhe as legjislacionit në fuqi që i referohet kësaj fushe te ndryshohet.

Kapitulli 9: Rekomandimi

Me plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji (Opsioni 2 i preferuar i ministrisë) do te rregullohet mandati i Agjencisë, pastaj procedura e pranimit, vlerësimit, ruajtjes se vlerës, shitjes apo asgjësimit te pasurive te sekuestruara ose konfiskuar. Rekomandimi është që Qeveria e Republikës se Kosovës të miratoj këtë Koncept Dokument dhe Opsioni 2 të rekomanduar nga MD, ne mënyrë qe administrimi i pasurive te behet ne mënyrë sa më të leverdishme dhe përftuese për shtetin. Në rast te miratimit të këtij Koncept Dokumenti, Ministria e Drejtësisë, do te përgatis dhe dorëzoj për miratim ne Qeveri, draftin përfundimtar te Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-141 për Administrimin Pasurisë se Sekuestruar ose te Konfiskuar.

Kapitulli 10: Komunikimi

Mund te jete e dobishme komunikimi përmes mjeteve elektronike dhe te shtypura për komunikim publik.

Përmes tryezave dhe konferencave te organizuara nga Agjencia ne bashkëpunim me Projektin e BE-se ne mbështetje te Agjencisë.